

AKTI I THEMELJMIT DHE STATUTII SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"METO 1892" SHPK

Date 15.05.2023

Sot me date 15/05/2023 Ortaku i Vetem i shoqerise:

- **Z.Sadik Ismailaj**, shtetas shqiptar, lindur me 03.02.1942, ne Siqec dhe banues ne Rr."Muhamrem Agolli", Fier, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, identifikuar me nr.personal E20203169J.

me cilesine e "Ortakut Themelues ", e angazhuar per te themeluar nje shoqeri te re tregtare ne Shqiperi, duke kuptuar plotesisht Kodin Civil ne fuqi, legjislacionin Shqiptar ne lidhje me shoqerite tregtare (ligjin 9901, date 14. 04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare "i ndryshuar), si edhe duke patur ne dispozicion te gjitha mjetet e nevojshme financiare si dhe idete per te themeluar nje biznes, nepermjet ketij akti, te hartuar dhe nenshkruar ne daten e sotme, shpreh vullnetin dhe angazhimin per te themeluar nje "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar ", si vijon:

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Shoqeria "Meto 1892" shpk rregullon poziten e saj juridike, marredheniet e ortakeve, te organeve te saj, llojin e shoqerise, kohezgjatjen e veprimtarise se saj, rnarredheniet me te punesuarit, duke u bazuar ne parashikimet e ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar dhe ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise dhe dispozitat e ketij Statuti.

KREU I  
Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti


**Neni 1**  
**Emertimi**

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "**Meto 1892** "Shpk.

**Neni 2**  
**Forma Juridike**

Shoqeria "**Meto 1892**" shpk eshte person juridik te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria "**Meto 1892**" shpk, eshte e tille, kapitali i se ciles ndahet ne kuota dhe qe themelohet nga ortaket qe perballojne humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.



### Neni 3

#### Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen Zona Industriale Fier-Patos,Zona Kadastrale 2890, Nr.pasuri 69/29 Patos.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, si dhe mund te marre pjese ne shoqeri te tjera shqiptare dhe/ose te huaja, qe ekzistojne ose do te krijohen ne te ardhmen.

### Neni 4

#### Objekti

Veprimtaria e shoqerise eshte:

- Grumbullimi i ullirit, perpunimi, prodhimi dhe amballazhimi i tij.
- Import-Eksport i vajit te ullirit,
- Perpunimi,prodhimi,importi dhe eksporti i mjaltit dhe nenprodukteve te tij,
- Perpunim, konservim, shitje e frutave – perimeve, te produkteve te recelit dhe kompostove te ndryshme ,
- Si dhe cdo aktivitet tjeter ne fushen e agrobiznesit qe konsiderohet fitimprures dhe ne interest e shoqerise,
- Shoqeria mund te kryeje cfaredo veprimtarie tjeter qe lejohet nga legjislacioni ne fuqi i Republikes se Shqiperise.

### Neni 5

#### Kohezgjatia

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

## **KREU II KAPITALI**

### Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 Leke (njeqind mijë leke) ky kapital do te ngurtesohet pasi shoqeria do te regjistrohet ne QKB dhe eshte i perbere nga 1 (nje) kuote, e cila zoterohet si me poshte:

Ortaku “**Sadik Ismailaj** - 1 (nje) kuote, me vlere nominale 100.000 Leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme.

Kontributi i ortakeve mund te jetet ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

Ortaku, qe pengohet te ushtroje te drejtat qe i rrjedhin nga zoterirni i kuotes se shoqerise, ka te drejte t'i kerkoje gjykates te urdheroje ndalirnin e cenimit apo shperblimin e demit te shkaktuar, si pasoje e cenirnit te ketyre te drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjeteve nga casti i cenimit.

**Neni 7****Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise rnund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit therneltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asne rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimln e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila rnerr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejen mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne. Projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar, ne rast se ka te tille, te pakten 45 dite perpara dates se mbledhjes se asarnblese te thirrur per te marre vendim rreth ketij projekti. Zvogelimi i kapitalit therneltar ne nje vlore me te vogel se ajo e percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti, e ben te detyrueshme rrnarrjen e nje vendimi prej shoqerise per zmadhimin e kapitalit themeltar te pakten deri ose vleren minimale.

Ne te kundert shoqeria duhet te shnderrohet ne nje forrne tjeter.

Ne rast mosbatimi te kerkesave te ketij paragrafi, cdo person i interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyqesore prishjen e shoqerise,

Kjo prishje nuk mund te shpallet, ne qofte se rregullimi eshte bere ne diten kur gjykata mblidhet per te marre vendim.

**Neni 8****Transferimi i kapitalit**

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjesa ne shoqeri, vetem me miratimin e shurnices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4 tre te katertat e pjeseve te kapitalit themeltar. Projekti i transferimit i njoftohet shoqerise dhe secilit prej ortakeve. Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit sipas paragafit te mesiperm, miratirni i transferimit konsiderohet i dhene,

Ne rast se shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, ortaket, brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi, duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar me vleren e percaktuar sipas rregullave te nenit 11 te ketij ligji.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme nderrnjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshrne me rruge trashegimie. Ato jane te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

**KREU III****ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE****Neni 9****Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakut te Vetem eshte organi vetem vendimmarres shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i veteri vendimnarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj, Asambleja e pergiithshme e ortakeve eshte perjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- percaktimin e politikave fregtare te shoqerise;
- ndryshimet e statutit;
- emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;

- d) percakrirnin e shperblimeve per personae e permendor ne shkronjat "c" dhe 'ç" te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire porgaritjen e pasqyrave financiare vjetore dhe le raporteve te ecurise se veprirntarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve le ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulirnin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe procedimet e tjera ndaj adrninistratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) cështje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne bazu te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund ce veprojne si perfaquesues i ortakeve ne asamblene e pergj ithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje le asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese mete njejtin rend dite.

#### Neni 10

#### Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret neperrnjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike, Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve jo ml: vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese, Kur asambleja e pergjithshre nuk eshte thirrur sipas pikes L le ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

#### Neni 11

#### Kuorumi

Ne rastin e rnarrjes se vendirneve, qe kerkojne nje shumice te zakonshre, asambleja e pergjithshme mund te marre vendirne te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligji "Per Tregtaret dhc Shoqerite Tregtare", ajo mund te marrë vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, Jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te këtij ligji. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorurnit te permendor me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njëtin rend dite.

#### Neni 12

#### Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelirnin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) crnerirnin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktirnin e shperblirneve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga adrninistratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise nc gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;



Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 13  
Administrimi

Administratori i pare i shoqerise eshte Z. **Sadik Ismailaj**, atesia Mehmet, shtetas shqiptar, lindur ne Siqec/Fier me 03.02.1942 dhe banues ne Fier ne adresen : MUHARREM AGOLLI 01490210; Nd. 26; H. 10, mbajtes i leternjofimit me Nr.034523626 dhe nr.personal **E20203169J**, e cila do te ushtroje funksionet ne kete detyre per nje periudhe 3 (tre) vjecare me te drejte riperteritet.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje ose zevendesoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti, apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Pervec kesaj, administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkese te cdonjerit prej ortakeve.

Tagrat e perfaqesimit te adrninistratorit dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrirn prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Neni 14  
Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprirntarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- c) pergatisi dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asarnblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijojne nje sistern paralajmerirni ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprirntarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dërgojne te dhena te detyrueshrre te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kornbetare te Biznesit;
- e) raportojne perpara asamblese se pergjithshre ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve le posacme me rendesi te vecante per veprirntarine e shoqerise tregtare;
- ë) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut

Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshrre brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te blejë nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiar te certifikuara.,

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e adrn inistrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjithe personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteteve shteterore Shqiptare apo te huaja,

perfshi ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne rnarredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoroin kete akt ne rrrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjafueshme.

### Neni 15 Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikërise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

I. a) ti kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e në interesin me te mire te shoqerise ne tërsi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis; b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;

ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te rnundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshrre me qellirnet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personae e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigen ndaj shoqerise ne rmenyre solidare.

4. Ne rmenyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, admnistratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

a) u kthen ortakeve kcntributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;

c) u shperndan aktivet shoqerise;

ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprirntarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht admnistratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrne padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe dernshperblirrin finanziar, nese eshte e nevojshrre. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyre.

**Neni 16**  
**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

**Neni 17**  
**Bilanci i shoqerise dhe dividentet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te Jene zbritur humbjet e vitit te rneparshem financiar, sic edhe parashikohet nga ligji.

**Neni 18**  
**Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate githevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakut te vetem.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit reportin me shkrim per nxjenjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejttes vendimore qe ka.

**Neni 19**  
**Te ardhurat neto**

(Dividenti ) qe mbeten pas vecimit te fondevit ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi te ortakeve.

**Neni 20**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelin e saj;
- b) me vendim te Asamblee se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- c) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per regjistrimin e biznesit", i ndryshuar;
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidirni kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per ernerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

**Neni 21**

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Nese shoqeria emeron me shume se nje likuidues, pervecse kur akti i emerirnit parashikon se ata veprojne vecmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojne bashkerisht te drejtat e detyrrinet sipas ketij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre te kryeje veprime te nje kategorie te posacne. Kufizimet e tagrave te likuiduesve u kundrejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit. Likuiduesi u nenshtrohet mbikeqyrjes se ortakut dhe administratorit.

### Neni 22

#### Te drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.
3. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditoret, sipas nenit 194 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit. Likuiduesi percatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne castin e hapjes se likuidirnit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi percatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te shoqerise. Bilancet ne shoqerine kolektive dhe komandite miratohen nga ortaket e tjere, ndersa ne shoqerite aksionare apo nga ato me perjegjesi te kufizuar miratohen nga asambleja e per gjithshme.

### Neni 23

#### Perfundimi i likuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Biznesit per perfundirnin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007" Per regjistrimin e biznesit" i ndryshuar.

### Neni 24

#### Bashkimi

Dy ose me shurne shoqeri rnund te bashkohen nepermjet:

1. Kalimit te te gjitha aktiveve e pasiveve te njeres ose me shume prej shoqerive, qe quhen shoqerite e perthithura, te nje shoqerie tjeter ekzistuese, e quajtur shoqeria perthithese, ne kembim te aksioneve apo kuotave te kesaj shoqerie. Ky proces quhet bashkim me perthithje.
2. Themelimit te nje shoqerie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqerive ekzistuese, qe bashkohen ne kembirn te aksioneve apo kuotave te shoqerise se re. Ky proces quhet bashkim me krijim i nje shoqerie te re.

### Neni 25

#### Ndarja

- 1.Nje shoqeri mund te ndahet me vendim te Asamblese se Ortakeve, duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet, vleresohet e prishur.
2. Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901 date 14.04.2008.
3. Shoqerite, qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet, quhen shoqeri pritese dhe per gjigjen ne menyre solidare per detyrimet e kesaj te fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit ka si pasoje:
  - a) kalimin te shoqerite pritese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet, ne perputhje

me reportin e ndarjes, te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja per marredheniet  
ndermjet shoqerive, si dhe per palet e treta;  
b) berjen e aksionareve/ortakeve te shoqerise qe ndahet aksionare apo ortake te nje ose me shume  
shoqerive prite se, ne perputhje me reportin e ndarjes, percaktuar ne rnarreveshjen e ndarjes;  
c) vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe cregjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e  
Regjistrimit, sipas seksionit V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per regj istrimin e biznesit", i  
ndryshuar pa kryerjen e likuidimit.

**Neni 26**  
**Shnderrimi**

Shoqeria mund ta ndryshoje formen e vet ligjore, nepermjet shnderrirnit te saj ne shoqeri aksionare  
Shnderrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve

**Neni 27**  
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plate me kete statut dhe dispozitat e legj  
islacionit shqiptar.  
Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe  
shoqerite tregtare" i ndryshuar, Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e  
Shqiperise.

**Neni 28**  
**Mosmarreveshiet**

Per mosmarreveshet qe rnund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretirnin e ketij statuti,  
si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë  
kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**Neni 29**  
**Dispozita perfimdimitare**

Ky statut u redaktua ne 2 (dy) ekzemplare me permnjte dhe vlera te njejtajuridike, ne gjuhen  
shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem i shoqerise tregtare  
"Meto 1892" shpk, nenshkruehet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen  
originale.

ORTAKU I VETEM

